

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18, dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 14 dhe 29 paragrafi (2) të Ligjit për Media ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 63/24, 74/24, dhe 218/24), Udhëzim për përmbushje të detyrimeve për impresium dhe informacion në dispozicion të përdoruesve, ark.nr.01-4443/1 datë 09.10.2018, pika 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimit të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-558/1 datë 04.02.2025 dhe Konkluzionin nr.02-737/11 datë 24.02.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 8-të mbajtur më 24.02.2025, miratoj si vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë, për shkak të shkeljes së nenit 14 të Ligjit për Media (LM), në mënyrë që transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv të transmetuar më 28 janar 2025, nuk ka publikuar të dhënat për impresium të inçizimit të Festivalit të Këngës dhe Valleve Shqipe, në inçizimin e manifestimit të mbajtur me rastin e emërtim të tri shkronjave të UÇK-së në fsh.Tanush dhe inçizim nga manifestimi i mbajtur me rastin e Ditës së alfabetit shqip.

Shkelja nga paragrafin (1) të kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-558/1 datë 04.02.2025, i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. DETYROHET SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi, ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e LM.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij konsiderohet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia, në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe nenin 29 të Ligjit për Media (LM), është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të mediave nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me detyrimet e përcaktuara në nenet 6, 8, 14 dhe 15 të LM.

Në përputhje me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV-së, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmerr masë - paralajmërim publik në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe akt tjetër të Agjencisë.

Në përputhje me nenin 29, paragrafi (2) të LM-së, masat që Agjencia, si organ rregullator kompetent, mund t'i ndërmarrë dhe që janë të përcaktuara në LSHMAAV, zbatohen përkatësisht edhe në rast të shkeljes së dispozitave të LM.

Në pikën 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, është përcaktuar se për shkeljet e konstatuara në vitin aktual, për të cilat janë shqiptuar masa në vitin paraprak, Këshilli i Agjencisë sërish do të shqiptoj masë paralajmërim publik sipas afateve të përcaktuara në Udhëzim.

Sipas nenit 14 të LM-së, botuesi i medias është i detyruar në vend të dukshëm për çdo bartës të përmbajtjes individualisht (për shembull mostër të medias së shtypit dhe emisioni televiziv) të

sigurojë publikimin e të dhënave në vijim: titull dhe adresë të selisë dhe redaksisë të botuesit të medias, emrin e personit përgjegjës të botuesit të medias, emrin dhe mbiemrin e redaktorit përgjegjës, përkatësisht redaktorëve në pajtim me organizimin e brendshëm të redaksisë dhe tutullin dhe adresën e botimit dhe datën e shtypjes ose ribotimit, si dhe numrin e kopjeve të shtypura, kur kemi të bëjmë për media të shtypit. Për transmetuesit deryrimi i mësipërm zbatohet në atë mënyrë që të dhënat të publikohen në fillim ose në fund të programeve audio/audi vizive. Botuesi i medias është i detyruar të publikojë të dhënat e mëposhtme në vend të përshtatshëm për çdo përmbajtje t'i publikon të dhënat në vijim: emrin dhe mbiemrin e autorit të shtojcës së publikuar, emrin dhe mbiemrin e personit, përkatësisht të firmës që ka të drejtën e autorit për përmbajtjen e publikuar, me përjashtim të mediave të shkruara dhe programeve në radio, data e produktionit (muajt dhe vitit), kur bëhet fjalë për vepër audio/audi vizuale, dhe nëse vepra është krijuar nga producent i pavarur dhe informacion për këtë, emri dhe mbiemri i personit që ruan pasurinë kulturore ose veprën arkivore, përkatësisht riprodhimin e duhur dhe emrin e botuesit të medias nga i cili është marrë shtojca e programit ose fragmenti nga shtojca e programit, përveç nëse me marrëveshje të përbashkët nuk është rregulluar ndryshe.

Në përputhje me Udhëzimin për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacionin në dispozicion të përdoruesve, ark.nr. 01-4443/1, datë 09.10.2018, për programet e tjera të prodhimit vendor, impresium publikohet në atë mënyrë që: në shpicën e hapjes dhe mbylljes publikon të dhënat në vijim. emrin dhe mbiemrin e redaktorit përgjegjës të shërbimit programor; emrin dhe mbiemrin e redaktorit përgjegjës të redaksisë nga ku buron programi (nëse ka): emrin dhe mbiemrin e redaktorit/autorit/ drejtuesit të emisionit; emrin dhe mbiemrin e bashkautorëve, pra të gjithë ekipit televiziv me pjesëmarrje në tërësinë e veprës audiovizive; emrin e subjektit që ka prodhuar programin (vetë transmetuesi, bashkëprodhuesit, producenti i pavarur të cilit i është porositur programi) dhe datën e produktionit (muajin dhe vitin). Nëse është e mundur, të dhënat duhet të publikohen të dhëna edhe për: emrin e personit juridik, përkatësisht emrin dhe mbiemrin e personit që ruan pasurinë kulturore të përdorur ose veprën arkivore, pra riprodhimin e veprës, dhe emrin e subjekti tjetër nga i cili është marrë shtojcë e caktuar ose pjesë e shtojcës, përveç nëse me marrëveshje të përbashkët nuk parashihet ndryshe.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 4 shkurt 2025, ka kryer mbikëqyrje të kontrollit administrativ (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë, transmetuar më 28 janar 2025, ku është konstatuar se transmetuesi nuk ka vepruar sipas aktvendimit për shqiptimin e masës - vërejtje publike PA1 03-353 të datës 26.12.2024, gjegjësisht nuk ka eliminuar shkeljen e kryer të nenit 14 të LM.

Konkretisht, mbikëqyrja konstatoi se në kundërshtim me LM dhe Udhëzimin për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacion në dispozicion të përdoruesve, pa impresium janë transmetuar: inçizim të Festivalit të Këngës dhe Valleve Shqipe, inçizim i manifestimit të mbajtur me rastin e emërtimit të tri shkronjave të UÇK-së në fsh. Tanush dhe inçizim nga manifestimi i mbajtur me rastin e Ditës së Alfabetit Shqip. Përkatësisht, në përputhje me LM dhe Udhëzimin në fjalë, në vend të përshtatshëm, për çdo përmbajtje të shërbimit programor, transmetuesi është i detyruar të transmetojë të dhënat që identifikojnë autorët që kanë marrë pjesë në përgatitjen e përmbajtjes: - *emrin dhe mbiemrin e redaktorit përgjegjës të shërbimit programor*; - *emrin dhe mbiemrin e redaktorit përgjegjës të redaksisë nga e ka origjinën programi*; - *emrin dhe mbiemrin e redaktorit / autorit / drejtuesit të emisionit*; - *emri dhe mbiemri i bashkautorëve, gjegjësisht i gjithë ekipit televiziv me pjesëmarrje në tërësinë e veprës audiovizive*; - *emrin e subjektit që ka prodhuar programin*; - *data e produktionit*.

Shkelja nga pika 1 të këtij vendimi, rështë specifikuar sipas datës, titullit të emisionit, periudhës së transmetimit (fillimi dhe mbarimi) dhe përshkrimi në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-558/1 datë 04.02.2025, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë, me datë 06.02.2025, dërgoj Shkresë nr. ynë ark.10-558/2 datë 06.02.2025, me të cilin ka dorëzuar Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-558/1 datë 04.02.2025, që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzoj deklaram me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LM. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 13.02.2025, për të cilën SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë nuk ka dorëzuar deklaratë me shkrim lidhur me shkeljen e

kryer të dispozitave të LM. Këshilli i Agjencisë, në seancën e 8-të mbajtur më 24.02.2025, shqyrtoi Raportin me shkrim në fjalë dhe konstatoi se ndaj SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë t'i shqiptoj masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht, nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 14 dhe 29 paragrafin (2) të LM, Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacionin në dispozicion të përdoruesve, pikat 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar), Raportit me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-558/1 datë 04.02.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-737/11 datë 24.02.2025, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LM, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 8-të mbajtur më 24.02.2025, ka miratuar Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë, dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi, të harmonizon punën e tij me dispozitat e LM Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij transmetuesi ka të drejtë padie për iniciimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-558/1 datë 04.02.2025.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi transmetuesi ka të drejtë padie për iniciimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.